- ✓ Tapet- 4cm ; Binder 6cm; Stabilizant 10cm; Cakell 20cm; Cakell 25cm per segmentet 31;42 (Seg. 42, eshte vleresuar me pakete te plote pasi nderhyrjet qe do behen , do shkaterrojne totalisht strukturen e saj)
- ✓ Siperfaqet perkatese te trajtuara me paketen e mesiperme jane: 809; 173; 695; 379; 1022;198;270;614;186;250;611; 8328 m² (sipas segmenteve)
- ✓

Realizimi i parametrave gjeometrike te mesiperm, do kerkojne realizimin e disa prishje qe konsistojne kryesisht ne mure rrethues. Ne zonat qe eshte parashikuar prishja apo spostimi i mureve rrethues eshte parashikuar gjithashtu realizimi i mureve te rinj (sipas detajeve perkatese qe jepen ne projekt). Ne seg. 42, eshte parashikuar te behet lidhja me seg rrugor Bashkimi, duke kerkuar kalimin ne gjurme teresisht te re. Kjo do kerkoje edhe prishjen e dy godinave te banimit ne menyre qe te sigurohet lidhja e saj me rrugen Ibrahim Pashe Bushatlliu.

Per te gjithë segmentet eshte parashikuar realizimi i rrjetit te ri per KUSH i cili parashikon vendosjen e pusetave te reja si dhe kolektoreve te rinj, etj. Rrjeti i ri i KUSH parashikon vendosjen e kolektoreve kryesore me tuba polietilene te brinjezuar SN 4 me diameter 250-315mm si dhe shkarkimin ne te pusetave ujembledhese (pusete me zgare gize). Organizimi i shkarkimeve te rrjetit te KUSH eshte bere mbeshtetur edhe ne mundesite qe te ofron terreni. Lidhja mes pusetave ujembledhese dhe kolektorit kryesor behet me tubacione d=250mm Pusetat ujembledhese do vendosen ne njeran ane apo dy anet nisur nga gjerësia e rrugëve apo siperfaqet ujembledhese. Ne projekt eshte parashikuar zgjatimi i kolektorit kryesor box 1.6x1.6m qe kalon ne rrugen Egnatia i cili do vazhdoje pothuajse duke ndjekur gjurmen e kolektorit ekzistuese dhe do shkarkoje ne lume. Seksionet terthore te ketij kolektori do ndryshojne nga 1.6x1.6m ne 2x1.6m dhe ne 2x1.8m duke marre parasysh edhe prurjet rrugore qe i shtohen. Ky kolektor eshte i tipit miks, ku shkarkohen si rrjeti i KUZ ashtu edhe i KUSH.

Nga azhornimet e marra si dhe verifikimet ne vend, eshte vleresuar qe ne segmentet ne fjale kane mungese te rrjetit te ujesjellesit. Jane parashikuar te shtrohen kolektoret kryesore te rrjetit te furnizimit me uje si dhe gjithashtu te realizohen degezimet perkatese per secilin nga konsumatorët. Materiali i tubacioneve per rrjetin ne fjale do jete polietilene me PN 10atm. Degezimet e konsumatoreve do realizohen deri ne afersi te kufirit te prones se gjithsecilit.

Eshte parashikuar gjithashtu realizimi i rrjetit te ri te KUZ i cili parashikon vendosjen e pusetave te reja si dhe kolektoreve te rinj, etj. Rrjeti i ri i KUZ parashikon vendosjen pergjate akseve te rruges te kolektoreve kryesore me tuba polietilene te brinjezuar SN 4 me diameter 250-315 mm si dhe realizimin e pusetave te kontrollit (me kapak gize). Ne keto puseta do behen shkarkimet nga objektet ne krah te rruges. Per pikat e shkarkimeve te ketij rrjeti do vleresohet pjerresia e terrenit si dhe mundesite qe ofrohen nga kuotat e shkarkimit te kolektoreve primare te bllokut.

Ne te gjithë segmentet kryesore, eshte parashikuar vendosja e rrjetit te ndricimit i cili do vendoset ne njeran ane te rruges. Ndricuesit me fuqi 150-250W do vendosen ne shtylla me lartesi 5.5-6.5-7.8m cdo 22-28m. Ne pjesen e rruges Egnatia, ndricuesit do vendosen me krah 1.5m. Per furnizimit te tyre do shfrytezohen linjat qe dalin nga kabina ekzistuese te cila shtrihet brenda bllokut .

Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu vendosja dhe realizimi i sinjalistikes perkatese se nevojshme, e cila perbehet si nga ajo horizontale ashtu edhe ajo vertikale, pershtatur kjo me parametrat gjeometrike te tyre si dhe me skemen qarkulluese te levizjes.

2.2 – TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI NDERHYRJET NE RRUGË DHE TROTUAREVE

Në zgjidhjen e projektit janë patur parasysh:

1. Zgjidhja në anën Planimetrike
2. Zgjidhja në anën Altimetrike
3. Elementet sociale

■ Zgjidhja Planimetrike (nderhyrjet).

Në zgjidhjen Planimetrike është patur parasysh krijimi i nje rrjeti rrugor i cili te sherbeje per perballimin e flukseve te qarkullimit te zones.

Nje kujdes është kushtuar edhe trajtimit te kryqëzimeve. Ne te gjithë kryqëzimet është bërë rakordimi i kthesave me rreze maksimale te mundshme dhe ate minimale sipas kushteve, në funksion të objekteve ekzistues kufizues.

Shume nga rrugicat jane teper te ngushta dhe me pamundesi zgjerimi si rezultat i objekteve te banimit dhe mureve rrethues.

■ Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik eshte pothuajse e sheshte. Eshtë synuar që niveleta e tyre të jetë sa me pranë asaj ideale, por duke respektuar edhe kuotat e hyrjeve te objekteve ekzistuese. Gjithashtu eshte bere rakordimi ne kuote me rruget ekzistuese.

■ Zgjidhja Sociale.

Duke patur parasysh që rruga kalon në një zonë pothuajse të ezauruar nga ana urbane, është patur parasysh ruajtja e nivelit ekzistues të rrugës, duke mos sjellë diferenca kuote në lidhje me hyrjet e apartamenteve apo rezidencave.

■ Shtresat e Rrugës

Nisur nga eksperinca ne projektimin e rrugeve, studimi i trafikut te zones dhe prespektiven e zhvillimit, studimi gjeologjik, vleresimi i

gjendjes aktuale, rezulton se ne keto pjese te rrjetit rrugor, jane te destinuar kryesisht per mjete te tonazhit te lehte dhe te mesem.

Meqenese jemi ne nje zone ku kemi mungese te theksuar te nenshtresave, kerkohet ne shumicen e rasteve te nderhyet me pakete te plote. Kete e perforcon akoma me teper edhe fakti qe ne trup te rruges do kryhen nje sere germimesh per rrjetet inxhinierike, pra trupi aktual do demtohet akoma me teper.

Ne vijim, paraqitet shkurtimisht procedura e llogaritjeve te kryera per percaktimin e paketes se shtresave ne rastin kur kemi pakete te plote bazuar ne CBR:

Te dhenat:

1. N_k -nr. i korsive te levizjes (sipas segmenteve)
2. N_a - nr.automjete/dite per te dy drejtimet gjate vitit te pare te ndertimit (sipas segmenteve)
3. $R = 7.5\%$ rritja vjetore e nr. te automjeteve
4. $V = 15$ vjet, periudha e shfrytezimit
5. $F = 2.5$, faktori i shkaterrimit per aksin standart , marre ne konsiderate per mjetet komerciale
6. $CBR = 5\%$ per nenshtresat e bazamentit

Llogaritjet :


1. Do pranojme qe faktori i shperndarjes se automjeteve $m = 0.75$ i cili merret sipas tabelës se meposhtme:

| Koeficienti i shperndarjes se automjeteve | Rruge me nje kors | Rruge me dy kors | Rruge me tre kors | Rruge me kater kors |
|--|-------------------|------------------|-------------------|---------------------|
| | $N_k = 1$ | $N_k = 2$ | $N_k = 3$ | $N_k = 4$ |
| m | 1.00 | 0.75 | 0.55 | 0.40 |

2. Duke zevendesuar parametrat e siperpermendur ne shprehjen e meposhtme, kemi qe trafiku llogarites do jete :

$$N = \frac{365 \cdot [(1+R)^V - 1]}{R} \cdot N_a \cdot m \cdot F \quad /10^6 \quad (msa)$$

3. Trashesia totale e paketes se shtresave per **CBR 5%** dhe trafiku llogarites **N (msa)** nga grafiket perkates te paraqitur meposhte merret :



Grafiku 1: Per trafik llogarites 1-10msa

4. Zgjidhet trashesia e paketes ne reference te N(msa) dhe CBR se shtresave
5. Perberja dhe trashesia e seciles shtrese do merret nga interpolimi i grafikeve perkates nga "Pavement Design Catalogue 2001"
6. Me poshte eshte paraqitur grafikisht paketa e shtresave bazuar mbi llogaritjet e mesiperme sipas pjeseve (tapet, binder, stabilizant, cakell).

Shtresat Rrugore se segmenteve kryesore

Ne segmentet kryesore, ku do nderhyhet me pakete te plote:

| | |
|-----------------|---------|
| Asfaltobeton | - 4cm |
| Binder | - 6 cm |
| Stabilizant | - 10 cm |
| Çakëll guroreje | - 20 cm |
| Çakëll guroreje | - 25 cm |

Shtresat Rrugore te rrugicave dytesore

| | |
|-----------------|------------------------------|
| Asfaltobeton | - 3cm |
| Binder | - 5 cm |
| Stabilizant | - 10 cm |
| Çakëll guroreje | - 15 cm |
| Çakëll guroreje | -15-20 cm (sipas segmenteve) |

Shtresat e Trotuarit

| | |
|---------------|---------|
| Pllaka betoni | - 6cm |
| Granil | - 7cm |
| Zhavor | - 25 cm |

Bordurat dhe Kunetat

Trupi i rrugës (pjesa kaluese) do të kufizohet me bordurë Betoni Parafabrikat M-250 me përmasa 15x30cm të fiksuara me beton M100-150. Bordura e rrugës do të vendoset mbi shtresat bazë të rrugës. (pasi mbi të në shumë raste takojnë apo ngjiten gomat e mjeteve.

Kunetat (ne segmentet ku aplikohen) do të jenë e shtruar me Beton M-250 me gjerësi 50cm. Ato do vendosen paralel me rrugën. Kuneta do te kete trashësi mesatare 15cm. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës prej 8%.

Ne trotuare, prane kryqezimeve, ne vendet e kalimit te kembesoreve jane parashikuar dhe rampat per kalimin njerezve me aftësi te kufizuar.

Shtresat e Trotuarit

Shtresat e trotuarit do të jenë:

| | |
|------------------|---------|
| Pllaka betoni | - 6 cm |
| Shtresë granili | - 7 cm |
| Shtresë zhavorri | - 25 cm |

Pllakat do jenë me dimension 15x30x6cm dhe 30x30x6cm te cilat do alternohen. Pllakat do jenë me ngjyre gri e errët. Mënyra e vendosjes së tyre, do jetë e alternuar, dhe është zgjedhur model i tillë vendosjeje qe te mos krijohen vija të vazhduara ne drejtim linear, në menyre qe difekte të vogla gjatë shtrimit të mos bien në sy. Në fillimet dhe fundet e çdo segmenti, si dhe në vendet e kalimit te këmbësore në rrugë, trotuari do të ndërtohet i ulur, për të bërë të mundur, lëvizjen lirshëm për njerëzit me aftësi të kufizuar, karrocave të fëmijeve etj.

■ Në të dy rastet, si në trupin e rrugës ashtu dhe në trotuare kasoneta pas gërmimit duhet detyrimisht të cilindrohet. Nëse gjatë gërmimit në ndonjë pjesë nuk arrihet heqja plotësisht e shtresës së sipërme, (vërehet

ndryshimi i formacionit), në atë pjesë të vashdojë germimi, dhe të mbushet me zhavorr. Gjithashtu germimi do vazhdoje edhe nese ne trup te rruges gjendet ndonjë kanal apo gropë septike e vjetër.

Gjatë realizimit të shtresave, detyrimisht të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike.

■ Plan-Organizimi i Punimeve te Ndertimit

Para fillimit te punimeve, nga ana e kontraktorit do te paraqitet tek supervizori i objektit Plan-Organizimi per kantierin ne fjale. Ne kete faze nuk eshte paraqitur Plan-Organizimi, pasi dokumenti ne fjale ndryshon nga disponibiliteti i shoqerise ndertimore (kontraktorit) ne lidhje me makinerite, fuqine puntore, teknologjite ndertimore, etj..

Bordurat dhe Kunetat

Trupi i rrugës (pjesa kaluese) do të kufizohet me bordurë Betoni Parafabrikat M-250 me përmasa 15x30cm të fiksuara me beton M-100. Bordura e rrugës do të vendoset mbi shtresat bazë të rrugës. (pasi mbi të në shumë raste takojnë apo ngjiten gomat e mjeteve.

Kunetat do të jenë e shtruar me Beton M-250 me gjeresi 50cm. Ato do vendosen paralel me rrugën. Kuneta do te kete trashësi mesatare 14cm. (me këtë realizohet pjerrësia tërthore e kunetës.

Ne trotuare, prane kryqezimeve, ne vendet e kalimit te kembesoreve jane parashikuar dhe rampat per kalimin njerezve me aftesi te kufizuar.

2.3 - TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI RRJETIN E UJESJELLESIT

Ujesjellesi: Rrjeti i furnizimit me uje ne kete zone ekziston. Nga informacionet e marra edhe nga drejtoria e ujesjellesit, ky rrjet paraqitet me probleme. Duke marre parasysh problemet e funksionimit si dhe prespektiven e zhvillimit, kerkohet nderhyrje ne realizimin e rrjetit te ri ne pjesen me te madhe te bllokut.

Projekti per rikonstruksionin e rrjetit te ujesjellesit eshte hartuar duke marre parasysh rekomandimet e paraqitura ne detyren e projektimit. Projekti eshte realizuar duke pasur parasysh disa faktore konkrete te kesaj zone si: pozicionin dhe shtrirjen gjeografike, rilevimi topografik i zones, numri banesave, numri i kateve te ndertesave, numri i bizneseve private dhe njesive te sherbimit ne kete zone, dendesia e popullsisë, norma e konsumit per banor, rreziqet ndaj zjarrit etj. Projekti parashikon ndertimin e rrjetit te ujesjellesit ne te gjithe zonen. Dimensionimi i rrjetit eshte bere duke pasur parasysh nje jetegjatesi per

nje periudhe 25 vjecare dhe normat e perdorimit te percaktuara ne detyren e projektimit. Gjate projektimit eshte marre parasysh qe rrjeti i ri qe do te ndertohet te adaptohet plotesisht nga ana funksionale me rrjetin e shtruar nga Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane. Ne llogaritjen hidraulike per dimensionimin e tubacioneve eshte marre parasysh dhe nevojat per konsumit per shuarjen e zjarrit. Rrjeti i ri qe do te ndertohet do te jete nje rrjet i unazor i cili garanton furnizim me uje nga dy drejtime dhe ruan presione konstante ne te gjithe zonen. Ne ndertimin e rrjetit te ri do te perdoren tuba polietileni te satndartit HDPE100PN10 (SDR17) ne te gjithe gjatesine e tij. Lidhja e tubacioneve nga Dj=63mm deri ne 200mm do te behet me manikota elektrofuzive me ngjitje. Realizimi i i pikave te lidhjes per tubacione Dj=63mm deri ne 200mm do te realizohet me "TEE" polietileni dhe manikota elektrofuzive sic jane parashikuar, dhe jo me fasheta elektrofuzive. Per pikat e lidhjeve me dimensione Dj=50, Dj=40 dhe Dj=32mm te behet me fasheta me kompresion, dhe rakorderite perkatese te jene me kompresion. Pika e furnizimit me uje per kete rrjet do te jene tubacionet e rrjetit ekzistues, sic eshte parashikuar ne projekt. Dimensionimi i rrjetit lejon qe kjo zone te furnizohet me uje sipas skemes se furnizimit nga Shoqeria Ujesjelles-Kanalizime Tirane. Llogaritjet hidraulike per dimensionimin e rrjetit te shperndares jane kryer duke perdorur formulen e Hazen-Williams qe shpreh raportin ndermjet disnivelit, prurjes, humbjeve dhe diametrit:

$$\Delta = JL = \frac{10.675Q^{1.852}}{C^{1.852}D^{4.8704}} L$$

Ku:

Δ – disniveli pizometrik (m)

J - humbjet (m/km)

L – gjatesia (m)

Q – prurja (l/sek)

D – diametri (mm)

C – koeficienti ashpersise qe per tubat e polietilenit merret C=150

Duke pranuar nje dendesi popullesie per nje zone me ndertime nga 2kt deri 12kt me 400-600 banore/ha. Norma e furnizimit eshte 150 liter/dite per banore. Per periudhen llogaritese 25 vjet pranojme nje norme rritje popullesie 3% dhe rezulton se ne baze te formules :

$$N = N(1 + 0.01p)^n$$


Ne pikat e lidhjes kryesore parashikohen puseta beton/arme me kapake gize. Keto puseta duhet te jene te pajisura me shkalle metalike dhe duhet te kene tub shkarkimi ne menyre qe te mos mbushen me uje gjate reshjeve ose nga ndonje avari. Tubacionet e rrjetit te ujesjellesit duhet te jene polietileni me presion nominal 10 atmosfere dhe saracineskat duhet te jene me presion nominal 16 atmosfere. Pas ndertimit te rrjetit te ri duhet te behen te gjithe lidhjet e konsumatoreve familjare dhe jofamiljare ne bashkepunim me Shoqerine Ujesjelles-Kanalizime Tirane. Lidhjet e konsumatoreve jane parashikuar te behen me tuba Dj=32 mm - Dj=50mm , dhe do te realizohen deri ne hyrje te prones tek kontatori i ujit.

2.4- TE DHENA TEKNIKE MBI RRJETIN E K.U.Z

Sistemi KUZ: rrjeti i K.U.SH ne kete zone ekziston por paraqitet me probleme te medha ne funksionimin e tij, per shkak se nje pjese e madhe e ketij rrjeti, eshte ndertuar nga vete banoret dhe eshte totalisht jashte kushteve teknike. Duke marre parasysh problemet e funksionimit si dhe prespektiven e zhvillimit, kerkohet nderhyrje ne realizimin e rrjetit te ri ne pjesen me te madhe te bllokut.

Projekti parashikon ndertimi i plote te nje sistemi te ri te shkarkimit te ujrave te zeza ne kete bllok. Rrjeti i ri do te jete nje rrjet i vecante qe do te sherbeje vetem marrjen e ujrave te zeza te zones. Ne kete projekt eshte parashikuar ndertimi i rrjetit KUZ me tuba polietilene te brinjezuar te standartit HDPE SN-8 me dimezime nga 250mm deri ne 600mm. Keto tubacione do te shtrihen ne te gjitha rruget e ketij blloku dhe do te lidhen nepermjet pusetave qe dote ndertohen ne gjitha banesat, shkolla, objekte private ose publike qofshin ato. Ne llogaritjet hidraulike eshte marre norma e perdorur dhe ne studimin japonez per Tiranen me 440 litra per banore ne dite. Mbeshtetur ne keto llogaritje jane bere dhe dimezimet e tubave ne segmente te ndryshme te rugeve te ketij blloku . Ne kete sistem te ri do te ndertohen puseta betoni rrethore me kapake gize. Keto puseta nuk do te jen me larg 25-50 ml ne gjatesi te rruges dhe patjeter ne cdo nje rrugeore apo aty ku ka thyerje te aksit te rruges. Tubat do te montohen me fashetat perkatese dhe do te mbullohen me rere ne te gjitha siperfaqen e tyre. Ne kete sistem te ri do te lidhen te gjitha shkarkimet e godinave familjare , publike dhe jo publike qe jane ne kete zone.

SHENIM : Eshte parashikuar zgjatimi i kolektorit ekzistues 1.6x1.6m te ujrave te larta pergjate segmentit « Egnatia » si dhe vazhdimin e ketij kolektori me dimezime 2.0x1.6m dhe 2x1.8m deri ne piken e shkarkimit. Ky kolektor do beje dhe mbledhjen e prurjeve nga kolektoret e tjere te zones (KUSH+KUZ), te cilat do shkarkohen ne Lumin e Tiranës.



2.5 – TE DHENA TEKNIKE MBI RRJETIN E K.U.SH.

Nuk ka nje rrjet te mirefillte te K.U.SH. Ne kohe me shi ne zonat e shesheve te pasistemuara, krijohen gropa dhe pellgje uji, te cilat perbejne nje shqetesim teper te madh per banoret. Ujrat shkarkojne ne forme natyrale, me rrjedhje te lire, sipas pjerrtesise se terrenit.

Konceptimi i rrjetit te ujerave te bardha eshte bere duke ruajtur parimin e ndarjes se ujerave te zeza nga ato te bardha.

Ne gjithe zonen qe do nderhyhet ne sistemimin e shesheve, ndertimin e rrugicave te reja , etj, do realizohet rrjet i ri per shkarkimin e ujerave te shiut.


Llogaritjet per dimensionimin e linjave te shkarkimit te ujerave te bardha jane bere duke marre ne konsiderate siperfaqet perkatese te pellgjeve (siperfaqet ujembledhese) per secilen linje. Prurjet e ujerave te shirave do te llogariten duke pranuar koeficientin e rrjedhjes ne varesi te llojit te terrenit.

Tubacionet qe do te shtrohen jane polietilene te brinjezuar SN 4. Pusetat e shiut dhe pusetat e shkarkimit do te jene prej betoni me zgare gize.

Shkarkimi i ujerave te shiut do i pershtatet mundesive qe te ofrohen me rrjetin e K.U.SH zones.

Ne te tere gjatesine e pjeseve qe do sistemohen, do te ndertohet sistemi i kullimit te ujerave te shiut. Ai do te perbehet nga kunetat prej betoni M-250 te vendosura ne nje apo te dy anet e rruges sipas menyres qe eshte konceptuar pjerrtesia e rrugeve apo shesheve. Kunetat do kene gjeresi 0.5m dhe pjerrtesi terthore 8-10%. Ne cdo 25-30m do ndertohen puseta shimbledhese me zgara gize me permasa 40x60cm. Pusetat do

ndertohen me beton M-200 dhe parete 15cm. Kapaket do jene gize (me menteshe) dhe te prodhuar per ngarkesa te renda. Kolektoret kryesor do realizohet me tuba PE te brinjuar me D-variabel (shiko planimetrine e KUSH). Keta tuba nese kalojne terthor me rrugen dhe mbi to do ushtrohet ngarkese e rende, per mbrojtjen e tyre eshte parashikuar veshja me beton M-100. Veshja me beton do behet me nje trashesi minimale 10cm per cdo ane te tubacionit. Tubat do te vendosen mbi nje shtrese rere 10cm dhe do mbulohen po me rere deri 10cm mbi kuroren e tubit.



2.5 - TE DHENA TEKNIKE MBI SISTEMIN E NDRICIMIT RRUGOR

Ne zonat e brendshme te shesheve te bllokut, ka mungese te plote te ndricimit rrugor. Kalimi naten eshte teper problematik per banoret.

Projekti prashikon ndertimin e ndricimit rrugor ne te gjithe gjatesine e segmenteve rrugore dhe shesheve qe jane objekt i kesaj kontrate.

Per sisteme te tilla rruges me trafik te perzier dhe ne zona periferike rekomandohet qe fluksi mesatar i ndricimit te mos i kaloje 20 lx, si dhe te mos jete me i vogel se 8 lx.

Per objektet, ne perputhje edhe me dimensionet, per keto kushte ndricimi kemi zgjedhur tipin e shtylles konike metalike e zinguar ne te nxehte me lartesi 5.5-6.5-7.8m – ndricues 150w-250w te vendosur, pa krah, me nje krah apo me shume sipas rastit ne funksion te hapesires qe do ndricohet (shiko planimetrine e ndricimit dhe detajet e shtyllave).

Shtyllat do te jete te vendosura ne trotuar. Ato do jene vendosur brenda bordures se betonit qe kufizon ate, ne menyre qe te jene te mbrojtura nga goditja e mjeteve.

Distanca ndermjet dy shtyllave do te jete rreth 20-28 ml.

Furnizimi me energji i ndricimit rrugor do te behet nga kabinat ekzistuese te zones qe ndodhet ne zone (shiko planimetrine e ndricimit) .

2.7 - TE DHENA TEKNIKE MBI SINJALISTIKEN RRUGORE

Në Projekt - Preventivin e sinjalistikës është parashikuar Sinjalistika horizontale dhe ajo vertikale, pershtatur me parametrat gjeometrike te rrugeve, skemes se qarkullimit, etj.

Sinjalistika Horizontale Do të përbëhet:

1. Rrugicat me dy sense levizjeje do te vijezen me dy vija te vazhduara me gjeresi 10cm ne ane dhe nje tjetër ne mes me vija te nderprera. Vijezi do te behet ne dy anet 50cm brenda bordures kufizuese te rruges.
2. Rrugicat me nje sens levizjeje (rruge te ngushta), do te vijezen me dy vija te vazhduara me gjeresi 10cm ne ane. Vijezi do te behet ne dy anet 50cm brenda bordures kufizuese te rruges.
3. Ne kryqezime dhe vende te caktuara do jene vijat e lëvizjes së këmbësorëve dhe shigjetat e drejtimit te levizjes.
4. Vijezi jane parashikuar gjithashtu edhe ne zonen e shesheve per ndarjen e senseve te levizjes se automjeteve, vijezi te kembesoreve si dhe kufizimeve te vendparkimeve te automjeteve.

Sinjalistika Vertikale do të përbëhet nga

1. Tabelat Detyruese.
2. Tabelat Treguese.
3. Tabelat Paralajmëruese.

Të gjitha tabelat do vendosen në trotuare, ngjitur me bordure kufizuese te tij.

2.8 – SHPRONESIMET

Ne baze te planit topografik te hartuar nga matjet direkte ne terren dhe planimetrise se rruges sipas projektit te perfunduar, lind domosdoshmeria e realizimit te disa prishjeve. Prishjet konsistojne kryesisht ne disa banesa 1-2kT, garazhde, mure rethuese te cilat nuk kane ndonje impakt shume te madh per komunitetin. Bashkelidhur projektit, jepet planimetria e prishjeve.

2.8 – KONKLUSIONE

Realizimi i punimeve per Studim Projektim “Rikualifikim Urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rruget “Don Bosko” - Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”, do ti jape ketij blloku nje frymemarrje te re dhe do permiresoje ndjeshem cilesine e jeteses se banoreve te tij.

Ndertimi i tij, do permiresoje ndjeshem qarkullimin e mjeteve brenda bllokut si dhe te kembesoreve, duke i krijuar atyre kushtet normale te ecjes ne rruget e Tiranës.

Realizimi i tij, do krijojë akses ne zones edhe nga segmente te tjere te rrjetit rrugor te qytetit.

Realizimi i elementeve te tjere te infrastruktures do kete nje impakt te ndjeshem. E ndjeshme do jete edhe permiresimi i cilesise se ajrit, duke ulur ne menyre te ndjeshme pluhurin dhe duke shtuar sasine e oksigjenit.

A – STUDIMI TOPOGRAFIK

Objekti i kontrates Studim Projektim “Rikualifikim Urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rruget “Don Bosko” - Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha” , ka një sipërfaqe rreth 43 ha shtrihet në pjesën veri – perëndimore të qytetit të Tiranës dhe është një zonë me ndërtime mikse nga ndertimet e ulta deri ne ato te larta dhe me një zhvillim të lartë urban.

Per hartimin e projektit dhe per nxjerrjen e nje serie te dhenash jane shfrytezuar hartat topografike te zones ne shkallet 1:25.000 dhe 1:10.000, fotot ajrore dhe satelitore te zones si dhe matjet e drejtperdrejta ne terren.

Hartat bazë te perdoruar ne shkalla 1:25.000 janë:

Harta me Nomenklature K-34-088-D-c

Harta me Nomenklature K-34-088-D-d

Hartat bazë te perdoruar ne shkalla 1:10.000 janë:

Harta me Nomenklature K-34-088-D-c-4

Punimet Gjeodezike

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin **“Rikualifikim Urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rruget “Don Bosko” - Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”**, u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojes se perftuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjitha projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit. Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projektioni Gauuss Kryger-it me ellipsoid Krasovsky-n.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projektionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren u pajisen me koordinata ne projektionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me goxhde betoni te ngulura ne objekte betoni. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e objektit qe perfshihen ne projekt.

Matjet u kryen me GPS TRIMBELL R6, Stacion Total te tipit Leica 307, Stacion Total te tipit Trimble M3 si dhe me nivele, te cilet teknikesht siguron matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve.



**Leica 307
TOPCON GPT 900 A**



GPS TRIMBELL R6

Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik

Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rilevuse, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithe sektoret e rruges dhe shesheve. Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti. Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm.

Rilevimi

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua procesi i matjeve topografike

Eshte rilevuar ne menyre te plote e gjithe siperfaqja e zones ku shtrihet objekti si dhe e nje brezi perimetral qe e qarkon ate. Ne relief jane pasqyruar ne menyre te plote te tere elementet perberes te tij, kanale, puseta, platforma betoni, shtylla ndricimi ose tensioni, bunkere, tombino, trotuare, ura, ndertesa, objekte te ndryshem, rruge kryesore e dytesore, perrenj, nje numer i dendur pikash detaje etj. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik e te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt. Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin STRATO dhe LEONARDO, TGO, Autocad Land Development nga ku eshte perftuar rilievi tre dimensional i objektit. Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori. Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e pikave poligonale dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijua bazamenti gjeodezik ne formen e nje poligoni te hapur (pika te forta) te cilat jane te mjaftueshme per marrjen (matjen) e pikave detaje te rilevimit. Matja e ketyre pikave u kryen me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave.

Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Keshtu per pikat deri ne 1km nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 2 km intervali 15 sek.


Element kryesor ne matjen 'stop&go' eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmatur futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit TRIMBLE R6 japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar.

Ne zonat me dendesi ndertimesh u perdor Stacioni Total pasi kishte peme dhe ndertime te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.

Bashkangjitur kemi paraqitur Katalogun e Skicave te Pikave Poligonale per te ndihmuar gjetjen e tyre lehtesisht gjate zbatimit te projektit.

Pika Poligonale Nr.1

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.1 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.615,197 | 4.577.021,731 | 94,07 |

Pika Poligonale Nr.2

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.2 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.573,978 | 4.577.084,402 | 93,97 |

Pika Poligonale Nr.3

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.3 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.493,305 | 4.577.096,036 | 93,72 |

Pika Poligonale Nr.4

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.4 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.285,946 | 4.577.247,632 | 91,08 |

Pika Poligonale Nr.5

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.5 | | |
|-------------------------------------|---------------|------|
| X | Y | Z |
| 399.260,487 | 4.577.311,764 | 91,2 |

Pika Poligonale Nr.6

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.6 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.310,968 | 4.577.296,323 | 91,71 |

Pika Poligonale Nr.9

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.9 | | |
|-------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.787,894 | 4.576.765,605 | 94,06 |

Pika Poligonale Nr.10

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.10 | | |
|--------------------------------------|---------------|------|
| X | Y | Z |
| 399.854,827 | 4.576.790,685 | 94,2 |

Pika Poligonale Nr.11

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.11 | | |
|--------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.734,128 | 4.576.624,711 | 92,06 |

Pika Poligonale Nr.12

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.12 | | |
|--------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.545,062 | 4.576.713,447 | 90,94 |

Pika Poligonale Nr.13

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.13 | | |
|--------------------------------------|---------------|------|
| X | Y | Z |
| 399.531,357 | 4.577.295,964 | 93,6 |

Pika Poligonale Nr.14

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.14 | | |
|--------------------------------------|---------------|-------|
| X | Y | Z |
| 399.576,787 | 4.577.207,079 | 93,73 |

Pika Poligonale Nr.15

Planimetria e pikes




Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.15 | | |
|--------------------------------------|---------------|--------|
| X | Y | Z |
| 399.928,590 | 4.576.665,614 | 95,005 |

Pika Poligonale Nr.16

Planimetria e pikes



Fotografi e pikes



| Koordinatat e pikes poligonale Nr.16 | | |
|--------------------------------------|-------------|--------|
| X | Y | Z |
| 399964,963 | 4576653,209 | 95,113 |

B – STUDIMI GJEOLOGO-INXHINIERIK

1.0 HYRJE

Ne periudhen Shkurt-Mars 2014, u krye studimi i kushteve gjeologo - inxhinierike te zones ku shtrihet objekti i kontrates **Studim Projektim** objektin **“Rikualifikim Urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rruget “Don Bosko” - Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”**,,per fazen e projekt zbatimit sipas variantit te pergatitur nga grupi i projektimit. Studimi eshte kryer sipas materialeve topografike te pregatitura.

Per rruget e bllokut te siperpermendur , jane kryer punimet e meposhtme:

1. Studimi i themelit te rrugeve
2. Studimi i vendeve ku ka mbushje ose germime me permasa te medha
3. Studimi i materialeve te ndertimit

1.1 Qellimi i Studimit

Destinacioni i ketij studimi eshte percaktimi i karakteristikave fiziko-mekanike te dherave dhe shkembinjve qe takohen ne zonen ku shtrihet objekti i kontrates se siperpermendur. Te dhenat e marra nga punimet fushore dhe ato laboratorike do ti sherbejne projektuesve per te parashikuar projektin e shtresave rrugore te rrugeve dhe shesheve, te rrjeteve te ndryshme inxhinierike, etj, qe shtrihen ne kete bllok banimi .

1.2 Objektivi i Punimeve

Shkurtimisht raporti shqyrton çeshtjet te cilat jane te mbeshtetura me punimet gjeologjike sipas programit paraprak.

1. Jane rishikuar te gjitha punimet e meparshme gjeologjike te kryera nga autoret dhe nga autore te tjere vendas te cilat jane kryer per qellime te tjera por kane vlere njohese. Jane shikuar te gjitha studimet e botuara dhe te pa botuara per zonen ne fjale.
2. Jane studiuar punimet gjeologjike te vjetra qe jane kryer per zonen e Tiranes.
3. Jane kryer punime te ndryshme sipas programit te hartuar me siper, por te kombinuar dhe me punimet ekzistuese te cilat jane shume te rendesishme per te kuptuar fenomenet gjeologjike qe kane ndodhur ne zhvillimin e historikut gjeologjik te kesaj zone.
4. Nje rendesi te vecante kane dhe testimet ne laborator te kampioneve te marre ne terren nga shpimet dhe gropave te hapura pergjate akseve te rrugeve.

Per vleresimin e ketij studimi pervec punimeve te reja sipas programit jane shfrytezuar punimet e meparshme te kryera per zonen ne fjale siç jane:

1. Studime gjeologo inxhinierike te kryera nga ndermarrja Gjeologji Gjeodezi per qytetin e Tiranes, Tirane. 1950 -1990
2. Studime gjeologo inxhinierike dhe gjeoteknike te kryera nga autoret per vepra te tjera te ndertuara ne zone ,viti 1996-2013

Studimet jane kryer konform standarteve qe jane ne marreveshjen e bere ndermjet paleve siç jane: ASTM.AASHTO.BSI.UNI.

2.0 GEOMORFOLOGJIA

Ne kete kapitull do te shtjellojme pershkrimin e zones ku shtrihen objektet e reja; format e relievit te sotem dhe te hershem, kushtet gjeologjike te formimit te ketij relievit. Do te behet pershkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

2.1 Vendodhja e zones ku do te ndertohet objekti i ri dhe pershkrimi i relievit

Zona ku shtrihet objekti i kesaj kontrate, eshte ne perendim te rruges "DON BOSKO". Zona ku do te kryhet ndertimi perfaqeson teracen e lumit Tirana. Teraca ndertohet nga formacionet gjysem shkembore te Neogjenit te cilet perajrohen lehte nga agentet atmosferike dhe lageshtira. Mbi keto shkembinj jane te vendosura depozitimet aluviale te lumit Tirana qe kane trashesi mbi 9.00-15.00m. Depozitimet Neogjenike kane trashesi 100-250 m. Depozitimet aluviale jane mesatarisht deri te konsoliduara.

2.2 Proceset fiziko- gjeologjike dhe gjeodinamike

Ne studimin e fenomeneve gjeologjike te kesaj zone jemi bazuar ne studimet ekzistuese dhe ne informacionet e reja qe kemi marre nga studimi aktual. Bazuar ne keto te dhena po bejme pershkrimin e fenomeneve gjeologjike qe jane prezente ne formacionet gjeologjike qe takohen ne kete zone.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe verehen ne kete zone jane:

1. Fenomeni i perajrimit
2. Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale

Keto fenomene po i shpjegojme nje nga nje me poshte:

1. **Fenomeni i perajrimit** eshte i dukshem tek formacionet rrenjesore qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite, keto shkembinj jane depozitime te reja dhe me cimentim te dobet argjilor, ato nen veprimin e agjenteve atmosferike transformohen nga shkembinj te bute ne dhera. Ky fenomen takohet me teper ne pjesen kodrinore te zones. Aty ku shkembinjte jane te zhveshur nga mbulesa deluvialo eluviale.
2. **Fenomeni i konsolidimit te depozitimeve aluviale.** Keto depozitime perbehen nga shtresa suargilash, surerash, zhavore dhe argjilash me permbajtje lendesh organike. Ne kete pjese te teraces jane te vendosura depozitimet e lumit te Tiranes, te cilat nderthuren me depozitimet e perrenjve te zones. Ne kohe te ndryshme kjo fushe ka qene dhe nje liqen i mbyllur ne te cilin jane depozituar materiale me granulometri te imet dhe lende organike. Shtresat qe permbajne lende organike jane te pakonsoliduara ose pak te konsoliduara. Ne sheshin e studjuar nuk jane

takuar shtresa me karakteristika te dobta fiziko-mekanike, por neqoftese gjate germimeve, takohet ndonje shtrese e tille menjehere duhet te lajmerohet gjeologu dhe projektuesi per te bere ndryshimet e duhura. Shtresat e rerave dhe te zhavoreve konsolidohen me shpejt ne kohe se sa shtresat me perberje argjilore. Ne zonen e studjuar kane drenim te mire te ujrave nentokesore por ne periudhat me rreshje masive niveli i ujit nentokesor eshte afer siperfaqes se tokes.

3.0 NDERTIMI GJEOLOGJIK DHE HIDROGJEOLOGJIK

Ne kete kapitull do te trajtojme perberjen gjeologjike te zones duke shfrytezuar punimet ekzistuese dhe punimet e kryera ne terren Bazuar ne materialin e grumbulluar po shtjellojme kushtet gjeologjike te ndare ne studimet ekzistuese dhe ne studimet e reja te kryera nga grupi i studimit.

3.1 Studimet Ekzistuese

Ne zonen ne fjale, jane kryer shume studime rajonale dhe lokale, keto studime jane kryer per objektet e ndryshme qe kane te bejne me qendrueshmerine e shpateve te kesaj zone si dhe per projektimin e themeleve te godinave te reja shumekateshe qe jane ndertuar ne kete zone.

Tirana ben pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise ne kete zone jane prezente depozitimet Neogjenike dhe depozitimet e Kuaternarit, por ne zonen ku do te ndertohet objekti jane prezente depozitimet e meposhtme:

3.2 Depozitimet Neogjenike (N₁^{2t})

Keto depozitime perfaqesohen nga argjilite, ranore, jane me cimentim te dobet argjilor, jane me carje. Keta shkembinj perajrohen lehte nga agjentet atmosferike dhe lageshtira duke krijuar nje cipe te trashes te mbuleses deluvialo - aluviale. Takohen nen depozitimet e Kuaternarit ne thellesite 7.00 – 9.80m. Ne shpatet e kodrave mbulesa deluvialo eluviale rreshqet ne drejtim te renies se relievit, por ne rastin tone sheshi i studjuar eshte ne terren te rrafshet, prandaj nuk eshte i kercenuar nga ndonje rreshqitje e mundeshme.

3.2.1 Depozitimet deluvialo - aluviale

Keto depozitime perfaqesohen nga suargjila, surera, rera dhe me rralle takohen shtresa zhavorore. Jane pak deri mesatarisht te ngjeshura. Takohen ne pjesen e siperme te prerjes dhe kane trashesi 7.00 – 9.80m. Jane depozitime te lumit Tirana te cilat nderthuren ne depozitimet e perroit te mullirit.

3.3 Kushtet Hidrogeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen e Lagjes Laprake-Don Bosko (nga matjet e kryera ne shpimet ne punimet e ndryshme qe autoret kane kryer per kete zone) rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i ndryshem ne dimer ai eshte shume afer siperfaqes kurse ne vere dhe ne vjeshte ai takohet ne thellesi te madhe. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja ne to jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithe periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte shume afer siperfaqes se

tokes (-4.00m). Ne zonen e studjuar ne momentin e shpimeve ka patur reshje masive dhe levizje te rrymave te ujrave siperfaqesore.

Nga analizat e kryera rezulton se jane ujra neutrale, ato nuk jane agresive ndaj hekurit dhe betonit.

Ne sheshin e studjuar takohen shtresa argjilore te cilat e mbajne lageshtine per nje kohe te gjate, aty uji nentokesor ngjitet deri afer siperfaqes si rezultat i kapilaritetit.

4.0 PUNIMET FUSHORE

Per percaktimin e kushteve te detajuara gjeologjike dhe gjeoteknike te zones ku shtrihet objekti i kontrates, eshte hartuar programi i detajuar i cili eshte respektuar gjate gjithë periudhes se studimit.

4.1 Qellimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kane per destinacion te percaktojne ne terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike ne zonen ku shtrihet objekti i kesaj kontrate. Ne fazen e punimeve fushore jane marre dhe kampionet me strukture te prishur dhe te paprishur per tu analizuar ne laborator. Ne kete faze jane identifikuar dhe fenomenet negative fiziko-gjeologjike qe jane prezente ne kete zone. Ne kete faze jane percaktuar formacionet gjeologjike moshë dhe tipi qe takohen ne sheshin e studjuar.

4.2 Inspektimi i Punimeve ne Terren

Te gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike dhe shpimet jane kryer nen mbikqyrjen e inxhinierëve gjeologe. Jane mbajtur te gjitha shenimet fushore te cilat jane krahasuar me te dhenat laboratorike. Mbi bazen e te dhenave te korektuara nga pershkrimi fushor dhe rezultatet laboratorike eshte bere perpilimi i Raportit Gjeologjik.

4.3. Planifikimi i Thellesise se Shpimeve si dhe Caktimi i Tyre ne Terren

Para fillimit te punes ne terren eshte bere studimi i draftit te projektit te detajuar mbi bazen e te cilit jane projektuar punimet fushore.

Per te vleresuar kushtet gjeologjike te zones ku do te ndertohen, per kete faze studimi jane parashikuar te hapen disa gropa me thellesi 2.50-3.00m

4.4 Gropat

Sipas programit te aprovuar, per bllokun ne fjale, jane hapur gropa me thellesi 2.50-3.0m ne disa nga akset e rrugeve **(shiko planimetrine e pozicionimit te gropave)**

4.4.1 Metoda e germimit

